



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:285784  
Datë: 22.04.2024  
Numri i dokumentit: 05601275  
PAKR.nr.196/24

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda me kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi - kryetar i kolegjit, Kadrije Goga Lubishtani dhe Hashim Çollaku-anëtarë të kolegjit, me praktikanten gjyqësore Erna Stublla si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarës F. G për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë nga neni 418 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe mbrojtësit të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.110/23 i datës 19.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 15.04.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHEN si të pabazuara ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe mbrojtësit të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.110/23 i datës 19.01.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.110/23 të datës 19.01.2024, të akuzuarën F. G për shkak të veprës penale përvetësimi

në detyrë nga neni 418 par.1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtores dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën dymijë euro (2000 €), si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara në afat prej 1 viti nuk kryen veprë të re penale.

E akuzuara është obliguar që dënimin e shqiptuar me gjobë në shumë dymijë euro (2000 €) në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, Gjykata dënimi e shqiptuar me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do ti caktohet një ditë burgim, përkatësisht 100 ditë burgim.

Të akuzuarës i është ndaluar ushtrimi i funksioneve në administratën publike dhe atë në kohëzgjatje prej 1 viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në kuptim të nenit 62 par. 2 të KPRK-së.

Është obliguar e akuzuara që në emër të dëmit material të ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 4,758.38 euro të dëmtuarës Spitalit Regjional në Prizren.

Është urdhëruar që dokumentet e sekuestruara përkohësisht të cilat janë përdorur si prova materiale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duhet të i kthehen të dëmtuarës Spitalit Regjional në Prizren.

Është obliguar e akuzuara që të i paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së Gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën dyqind euro (200 €), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën pesëdhjetë euro (50 €), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.110/23 i datës 19.01.2024 përkitazi me vendimin mbi dënimin kryesor, ashtu që të akuzuarës F. G për veprën penale përvetësim në detyrë nga neni 418 par.1 të KPRK-së të i shqiptoj dënim më të lartë se sa dënimi i shqiptuar në kufi të minimumit dhe maksimumit të lejuar ligjor, duke u bazuar në shtojcën 1- tabela për matjen

e dënimit të udhëzuesit për politikën ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

Mbrojtësi i të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës të e aprovoj si të bazuar ankesën e mbrojtjes dhe ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.110/23 i datës 19.01.2024, në favor të akuzuarës vetëm sa i përket masës së dënimit plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publikë në kohëzgjatje prej një viti.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën PPA/I.nr.185/2024 e datës 25.03.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.263/22 e datës 22.02.2024 e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.110/23 i datës 19.01.2024, ashtu që aktgjykim i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarës F. G t’i shqiptohet dënim me burgim dhe dënim me gjobë me i lartë sesa me aktgjykimin e ankimuar. Ndërsa të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj, e ushtruar kundër aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit të Kosovës, mbajti seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 390 paragrafi 1. të KPPK-së në të cilën ka marrur pjesë mbrojtësi i të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj. Ndërsa, Prokurori i Apelit, e akuzuara F. G dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar L.M, nuk prezantuan në seancën e kolegjit, ndonëse të njoftuar në kohë dhe në mënyrë të rregullt. Mbrojtësi i të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj në seancën e kolegjit deklaroi se ne edhe në ankesë sa i përket dënimit kryesor nuk kemi shfaqur vërejtje. E mbrojtura ime tek kryerja e veprës penale ka ardhur si pasojë e pakujdesisë profesionale, pra në rastin konkret nuk përfshihet elementi i dashjes. Propozoj që Gjykata e Apelit të shqyrtoj edhe një herë nëse dënimi plotësues është proporcional me veprën penale. Konsiderojmë se shqiptimi i dënimit plotësues do të degradoj personalitetin e saj.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe mbrojtësit të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren

Prokurori pretendon që aktgjykimi i ankimuar përkitazi më vendimin mbi dënim nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj, për shkak se Gjykata e shkallës së parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese në të dëm të rrethanave rënduese.

Sipas Prokurorit, rrethanat lehtësuese që i ka gjetur Gjykata e shkallës së parë nuk mund të jenë rrethana aq lehtësuese sa të akuzuarës ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Madje, Prokurori pretendon se mosha dhe arsimi i saj gabimisht janë vlerësuar si rrethana lehtësuese, sepse të njëjtat është dashur të konsiderohen si rrethana rënduese për shkak se me të njëjtat dëshmohet që e akuzuara ka kryer veprën penale duke pasur njohuri në fushën ekonomike dhe juridike, me vetëdije që është duke vepruar në dëm të pasurisë shoqërore, në kundërshtim me autorizime e saja që dalin nga detyra e saj e punës, si dhe në moshë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të punës.

Po ashtu, Prokurori shton se Gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar përse nuk i ka marrur parasysh të gjitha rrethanat rënduese të propozuara në aktakuzë. Prokurori thekson se Gjykata nuk ka vlerësuar as këmbëngulësinë e të akuzuarës e cila gjatë gjithë procedurës penale të zbatuar në Prokurori është munduar ti inkriminojë të tjerët për përvetësimin e parave, që vërtetohet nga vet deklarata e saj, me të cilën deklaratë mund të zbehet besueshmëria e publikut në institucionet shëndetësore dhe provohet shkalla e lartë e dashjes së të akuzuarës gjatë konsumimit të veprës penale.

Për më tepër, Prokurori shpreh se Gjykata e shkallës së parë nuk ka marrur parasysh propozimin e Prokurorit në aktakuzë lidhur me dënimin, si dhe e njëjta i ka shqiptuar të akuzuarës dënim të kushtëzuar si të ekzistonin rrethanat që arsyetojnë zbutjen maksimale të dënimit brenda kufirit. Prokurori thekson se sipas tabelës për matjen e dënimit të udhëzuesit për politikën ndëshkimore të Gjykatës Supreme të Kosovës, në rastet kur kemi më shumë rrethana lehtësuese sesa rënduese, përcaktohet dënimi minimal prej një (1) vjet e gjashtë (6) muaj. Prokurori konsideron se në rastin konkret ekzistojnë më shumë rrethana rënduese sesa lehtësuese, andaj Gjykata është dashur të akuzuarës të i shqiptoj dënim me burg të pakushtëzuar më pikënisje për matjen e dënimit konform tabelës së cekur.

Sipas vlerësimit të Prokurorit, dënimi i shqiptuar nuk është në harmoni me intensitetin e dëmit të vlerës së mbrojtur, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës, si dhe është në disbalancë mes mundësisë së risocializimit të akuzuarës dhe kërkesës së shoqërisë për sigurimin e funksionit parandalues të dënimit të shqiptuar. Prokurori konsideron se me këtë dënim nuk mund të arrihet morali dhe forcimi i detyrimit të respektimit të ligjit, i njëjti nuk do të jetë preventivë e

përgjithshme dhe as nuk do të rris besueshmërinë e publikut në institucione publike, gjykata dhe në prokurori.

### Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj

Mbrojtësi i të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj thekson se e akuzuara që në shqyrtim fillestar ka pranuar veprën penale e cila i është vënë barrë dhe ka deklaruar se ndjen keqardhje për kryerjen e veprës penale, deri te e njëjta ka ardhur si pasojë e pakujdesisë dhe përvojës së vogël profesionale në pozitën që e ka ushtruar, si dhe se është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe që del para një Gjykate. Madje, e akuzuara ka shprehur vullnetarisht gatishmërinë për ta bërë kompensimin e të dëmtuarës dhe ka deklaruar që në të ardhmen nuk do të përsëris më veprime të tilla apo të ngjashme. Po ashtu, mbrojtja shton se pala e dëmtuar ka qenë e pranishme në shqyrtimin fillestar dhe përpos realizimit të dëmit nuk ka pasur ndonjë kërkesë tjetër të veçantë lidhur me dënimin eventual të akuzuarës.

Mbrojtja pretendon se Gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave relevante dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka ashpërsuar masën ndëshkuese duke mos marrur parasysh qëndrimin e të akuzuarës ndaj veprës penale, rrethanat e tjera të paraqitura në seancë, evidencën e saj të pastër penale, ndërmarrjen e veprimeve për eliminimin e pasojave të veprës penale, si dhe personalitetin e të akuzuarës, pasi që sipas mbrojtjes po të ishin vlerësuar drejtë këto rrethana do të kishim një masë të dënimit më proporcional.

Për më tepër, sipas vlerësimit të mbrojtjes dënimi plotësues i shqiptuar ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratën publike në kohëzgjatje prej një viti është jo proporcional dhe të akuzuarës i shkakton dëm të pa kompensueshëm, pasi që si rrjedhojë e kësaj mase e njëjta do ta humb vendin e punës. Po ashtu, sipas mbrojtjes ky dënim plotësues nuk i kontribuon risocializimit dhe personalitetit të akuzuarës, madje një masë e tillë do të ndikoj negativisht edhe në gjendjen psikike të akuzuarës.

### Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Ndonëse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin lidhur me shkeljet e tilla e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 394 par.1 të KPPK-së gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin anulimin e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar Gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore meqë e akuzuara ka pranuar fajësinë). Prandaj, aktgjykimi u vlerësua vetëm lidhur me pretendimet ankimore të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe mbrojtësit të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj, sa i përket vendimit mbi sanksionin penal.

#### Vlerësimi i Gjykatës lidhur me vendimin mbi dënim

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit konstaton se pretendimet e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe mbrojtësit të akuzuarës F. G, av. Muhamet Shalaj janë të pabazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës, sjelljen korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimin e thellë për kryerjen e veprës penale, faktin që gjerë më tani ka qenë e pa gjykuar (që nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive), moshën e saj, si dhe arsimimin e saj. Ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar peshën e veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale, andaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjyimit të ankimuar. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo Gjykatë dhe gjen se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Ndërsa, pretendimet e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren se Gjykata e shkallës së parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese në dëm të rrethanave rënduese, i ka vlerësuar gabimisht rrethanat rënduese si rrethana lehtësuese, nuk e ka marrur parasysh propozimin e Prokurorisë lidhur me dënimin, nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm dënimin e shqiptuar, si dhe nuk ka shqiptuar dënim proporcional me veprën penale dhe peshën e saj, janë pretendime të pabazuara pasi që në rastin konkret rrethanat të cilat Prokurori i thekson në ankesë veç se kanë qenë objekt i vlerësimit të Gjykatës së shkallës së parë dhe vlerësimin e këtyre rrethanave edhe kjo Gjykatë e konsideron si të drejtë. Po ashtu, sipas Gjykatës së Apelit, Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar mjaftueshëm shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të aktgjyimit të ankimuar. Gjithashtu, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarës se Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar

drejtë rrethanat lehtësuese dhe se me ekzekutimin e dënimit plotësues të shqiptuar do të ndikohet negativisht në risocializimin dhe personalitetin e të akuzuarës, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë pretendime të pabazuara pasi që rrethanat lehtësuese nga ana e Gjykatës së shkallës së parë drejtësisht dhe ligjshëm janë marrur parasysh me rastin e shqiptimit të dënimit. Po ashtu kjo Gjykatë vlerëson se shqiptimi i dënimit plotësues përkon me veprën e kryer penale dhe peshën e saj. Andaj, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kësaj Gjykate janë bazë e mjaftueshme për arsyetimin e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe më intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se më të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti për Krime të Rënda

PAKR.nr.196/24, datë 15.04.2024

Praktikantja gjyqësore

Erna Stublla

\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit

Kadrije Goga Lubishtani

\_\_\_\_\_

Hashim Çollaku

\_\_\_\_\_

Kryetar i kolegjit

Xhevdet Abazi

\_\_\_\_\_